



Republika e Kosovës - Republika Kosova  
Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborna komisija za žalbe i molbe

A nr. 20/2009

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia, në panelin e përbërë nga Osman Tmava, kryesues, Fahredin Ymeri dhe Muharrem Shala, anëtarë, përkitazi me Ankesën e z. Bedri Çeku nga partia Balli Kombëtar, në seancën e mbajtur më datë 20.10.2009, mori

### VENDIM

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

### ARSYETIMI

Z. Bedri Çejku nga partia Balli Kombëtar, ka parashtruar ankesë me të cilën pretendon se Komisioni Qendror Zgjedhor, përkatësisht drejtoresha e KQZ-së Miradije Mavriqi, ka nëpërkëmbur dhe anashkaluar rastin e Ballit Kombëtar/ Nr. – 16, datë 18.08.2009.

### FAKTET

Më 16 Tetor 2009, Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (KZAP) ka pranuar një ankesë nga Z. Bedri Çejku, kryetar i partisë Balli Kombëtar, i cili ka parashtruar ankesë me të cilën pretendon se Komisioni Qendror Zgjedhor, përkatësisht drejtoresha e KQZ-së Miradije Mavriqi, ka nëpërkëmbur dhe anashkaluar rastin e Ballit Kombëtar/ Nr. – 16, datë 18.08.2009.

Miradije Mavriqi ka favorizuar palën tjetër "Ballin Kombëtar" të cilët kanë punuar dhe vepruar jashtë normave të Statusit të Partisë të Ballit Kombëtarë, dhe kështu janë penguar 12 komitete (degë) në 12 qytete të Republikës së Kosovës pa u përfshi në Zgjedhjet Lokale të 15 nëntorit.

### ANALIZË

Jurisdiksioni i KZAP-it lidhur me ankesat është caktuar në pajtim me kompetencat e dhëna nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në *Ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP* (Ligji nr 03/L- 073) dhe *Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën Kosovës* (Ligji nr 03 / L-072).

Në bazë të Rregullave dhe Procedurave të KZAP-it, Neni 8.8 të gjitha ankesat duhet të kenë së paku informacionet vijuese:

- a) emrin, adresën dhe informacionet për kontaktim të personit që dorëzon e apelimin;
- b) arsyen për dorëzim të apelimit;
- c) hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të personit që e dorëzon apelimin apo udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të parashtruesit të apelimit: dhe
- d) vërtetimin nga personi që e dorëzon apelimin lidhur me vërtetësinë e përmbajtjes së apelimit.

Ankesa është e paqartë, e pa-kuptuar dhe nuk përmban bazë të duhur ligjore.

Për më shumë, në Rregullat dhe Procedurat e KZAP-it, Neni 9.2 përcakton se KZAP-i mund t'i refuzoj apelimet që nuk i plotësojnë kriteret e parapara në nenin 8 të këtyre rregullave dhe procedurave apo që nuk i respektojnë dispozitat e duhura ligjore.

Për më shumë, bazuar në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Neni 26.6, dhe në Rregullat dhe Procedurat e KZAP-it, Neni 8.5, përveç nëse nuk është saktësuar ndonjë afat tjetër, ankesa duhet të dorëzohet brenda pesë ditëve pas ndodhjes së shkeljes së pretenduar apo brenda pesë ditëve pasi që për shkeljen e pretenduar është njoftuar parashtruesi i ankesës ose nga dita kur ai është dashur të dijë për të. Meqenëse ankesa është dërguar në KZAP më 16.10.2009 dhe partia Balli Kombëtar ishte njoftuar me vendimin e KQZ-së më 18.08.2009, kjo ankesë ka qenë e dërguar në KZAP përtej periudhës 5 ditore, siç specifikohet në Nenin 8.5 të Rregullave dhe Procedurave, prandaj refuzohet.

**Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë**

A nr. 20/2009 më datën 20/10/2009

**Kryesuesi i Panelit**

**~~Osman Tmaja~~**